



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT  
TË PUNËVE PUBLIKE

---

DETYRË PROJEKTIMI

“RESTAURIMI DHE MUZEALIZIMI I MUZEUT ETNOGRAFIK  
TIRANË”

(Monument Kulture Kat. I-rë)

Tiranë, Maj 2024

Bashkia e Tiranës, me fondit 7.749.866 lekë me tvsh kërkon të realizojë Studim Projektimin dhe Muzealizimin për objektin: “Restaurimi dhe Muzealizimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”, Ky projekt do të kërkohet të synojë ngritjen e Muzeut Etnografik të Tiranës, “METi”, në godinën dhe hapësirën që sot njihet ndryshe me emrin “Sarajet e Toptanasve”, i cili në listën zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), rezulton me emertimin “GODINA ISH BIBLIOTEKA KOMBËTARE (ish Sarajet Toptanët), Lagjia 28 NËNDORI, NR.7, RR. "ALQI KONDI", me kod (I-08) dhe është Monument Kulture i Kat. I-rë, shpallur me:

1- Vendim Nr.6, datë 15.01.1963, nga Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës

2- Vendim Nr. 1886, datë 10.06.1973, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës

Për lehtësi më poshtë po i referohemi si “Ish Sarajet e Toptanasve”, si toponimi më i njohur në memorien kolektive qytetare.

**\*Vendim Nr. 619, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rijetësimi i “Banesës së Toptanasve” Muzeu Etnografik i Tiranës”\***



*Ortofoto e Pozicionimit të Objektivit*

## **1. Të përgjithëshme**

### **1.1 Rëndësia e Stilit/ Historia dhe situata ekzistuese**

Në kontekstin historik, qyteti i Tiranës, në lindjen dhe zhvillimin e tij, ashtu si çdo qendër paraqet veçanti, të cilat pasqyrojnë karakteristikat dhe me gjerë realizimet e qytetit shqiptar të shek. XV – XIX. Deri në çerekun e parë të shekullit të XIX qyteti shtrihej përmes bërthamës ku ndodheshin pazari dhe dy xhamitë e vjetra. Qyteti i Tiranës dukej i çrregullt, i shtrirë dhe i fragmentuar për shkak të trashëgimisë feudale dhe të prapambetjes ekonomike dhe kulturore. Në thelbin e vet qendra e banuar e Tiranës, gjithnjë duke pasur rol historik, krahasimisht me e lartë e parapëlqyer

si banim, është një shembull me vlera për kalimin shkallësor nga një qendër fshatare në atë qytetare, madje në rrethana të veçanta në shek. XX për të qenë dhe kryeqyteti i Shqipërisë.

Toptanët janë nga familjet e pakta të mëdha të Shqipërisë dhe njëkohësisht nga familjet më të shquara të Tiranës, ata i përkasin shtresës së lartë të shoqërisë shqiptare (bejlerëve). Toptanët kanë qënë rreth 15 familje, duke nënkuptuar prezencën e shumë shtëpive në pronësi të tyre, nga të cilat sot kanë mbetur vetëm disa, një prej të cilave është dhe “Godina e Ish Bibliotekës Kombëtare (Ish sarajet e Toptansve), sipas regjistrimit kombëtar të pasurive kulturore.

## 1.2 Pozicionimi i sitit

|  |                                 |
|--|---------------------------------|
| - Emri:                                    | Muzeu Etnografik I Tiranës.     |
| - Koordinatat:                             | 41° 19' 38" N 19° 49' 16" E     |
| - Hyrja:                                   | Nëpërmjet rrugës “Abdi Toptani” |
| - Sipërfaqe sheshi rreth:                  | 1680 m <sup>2</sup>             |
| - Sipërfaqe e ndërtesës ekzoistuese rreth: | 1300 m <sup>2</sup>             |

*(Shënim: të dhënat e mësipërme duhet të nxirren të sakta nga rilevimet faktike të objektit dhe truallit)*

“Sarajet” ndodhen në rrugën “Abdi Toptani”, në një kontrast me pallatet shumë katëshe aty pranë. Para disa vitesh ky vend ka funksionuar si “bar-restorant” por tashmë është i mbyllur dhe nuk lejohen vizitorë.

## 1.3 Specifikime të Godinës dhe Silit

Kjo banesë është një objekt përfaqësues i arkitekturës vernakulare të shek të 20, me element arkitektonikë autentikë, me shumë pak ndërhyrje gjatë kohës, ku për këtë arsye është shpallur Monument Kulture i kategorisë së I-rë nga Rektorati i Universitetit Shtetëror me vendimin nr. 6 datë 15.01.1963 dhe më vonë nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendimin nr 1886 datë 10.06.1973. Kjo e bën thelbësore rëndësinë e mbrojtjes, konservimit, restaurimit dhe rijetëzimit të objektit.

“Sarajet u ndërtuan rreth viteve 1833-1840 dhe janë një nga të paktat saraje feudalësh të ruajtura në Shqipëri. Kompleksi paraqet interes nga ana ndërtimore, si për kompozimin funksional dhe për trajtimin arkitektonik – dekorativ.

Në fazën e parë të ndërtimit të saj ka qenë me çardak e hajat në ballin kryesor. Shtëpia e zjarrit është bërthama e mjediseve për qark saj. Në katin e parë janë ambientet ndihmëse ndërsa në katin e dytë ambientet e ndenjes dhe anekset e shërbimit. Shkallët që lidhin ambientet janë një ramëshe druri.

Në fazën e dytë, në fillim të shekullit të XX, u bë një rikonstruksion i mjediseve si dhe mbyllja e çardakut.

Në fillim të shekullit të XX, ka qenë dhe selia e legatës së SHBA.

Godinat (godina kryesore dhe godina ndihmëse) janë të zbukuruara me dekoracione të ndryshme. Ato përbëjnë një kompleks arkitektonik me mure, oborre, puse, rrugë, porta të mëdha, banesa dhe ambiente ndihmëse.

Banesa ka brenda një “Hamamxhik” (hamam me dimensione të vogla).

Për analizën e gjendjes së konservimit të pasurisë kulturore, monument Kulture i kategorisë së I – rë, godina u inspektua duke marrë në shqyrtim të gjithë materialet teknike të disponueshme dhe natyrisht kqyrjes vizuale në vend.

### **1.3.1 Historiku i përdorimit të godinës.**

Nga shqyrtimi i materialit arkivor vërehet që ndër vite kjo strukturë është përdorur në periudha të ndryshme për funksione të ndryshme disa prej të cilave po i cilësojmë më poshtë në mënyrë të përgjithshme.

Shek.18: Shtëpi e familjes Toptani,

Shek.19: Pronë e Familjes Libohova,

Vitet 1925-1928: Ambasada e Shteteve të Bashkuara,

Vitet 1928 -1939: Bibloteka Kombëtare gjatë mbretërimit të Mbretit Zogu – I-rë,

Vitin 1945: Bibliotekë, pronë shtetërore gjatë periudhës komuniste,

Vitin 1963: Zyra të Insitutit të Monumenteve të Kulturës,

Vitin 1973: Kategorizohet si monument kulture,

Vitin 1990: Insituti i Gjeografisë së Akademisë së Shkencave (laboratory i restaurimeve)

Vitin 1990: I rikthehet si pronësi ish pronarëve.

Vitin 2013: Përdorur si Bar Restorant.

Vitin 2021: Pronësi e Bashkisë së Tiranës.

Në ditët e sotme duke vlerësuar dhe rëndësinë e sitit , hapësirat që ka kjo strukturë dhe përshtatjeve të realizuara në vite, vlerësojmë se duke qenë se objekti nuk funksionon më si banesë familjare, hapësira në fjalë të kthehet në muzeun Etnografik të Tiranës, kjo duke vlerësuar dhe pozicionin strategjik në qendër të Tiranës.

### **1.3.2 Tipologjia e ndërtimit dhe hapësirat e brendëshme**

Banesa dy katëshe është e ndërtuar nga mjeshtrat dibranë. Ajo vendoset në një parcel të rrafshët me orientim nga jug-lindja, duke i drejtuar diellit pamjen kryesore. Ajo ndodhet në zemër të Tiranës dhe zonës arkeologjike A të saj. Brenda rrethimit aktualisht gjenden dy objekte, banesa kryesore 2 katëshe dhe një godinë një kat në pjesën e pasme të oborrit.. për të arritur në banesë kalohet nga një portë e madhe përgjatë rrugës “Abdi Toptani”.

1 – Godina Kryesore

Kjo godinë ka një sipërfaqe rreth 1050 m<sup>2</sup>, e kompozuar ne dy kate.

2 – Godina ndihmëse

Kjo godinë ka një sipërfaqe rreth 250 m<sup>2</sup> e kompozuar në një kat.

3 – Hapësirat përreth godinave.

Hapësirat përreth dy godinave kanë një sipërfaqe të përgjithshme rreth 900 m<sup>2</sup>.Guzhina është vendosur në katin përdhe, ngjitur me dhomën e ndërrimit.Dhomat e ndenjes dhe të gjumit janë të pozicionuara në katin e parë.Gjithashtu godina dispononte një “Hamam”në brendësi të saj.Tualetet kryesisht ishin pozicionuar pranë dhomës së ndenjes ku ngroheshin me sistemin e avujve të guzhinës dhe murit të oxhakut kryesor.Kjo godinë u ndërtua nga mjeshtra ustallarë të zonës së Dibrës.

### **1.3.3 Analizë e materialeve të përdorura në konstruksionin original të ndërtesës.**

Nga materialet arkivore vërehet që ndërhyrjet restauruese të viteve 70-80 kanë qenë të thella edhe në konstruksion. Kjo ndërtesë në fillimet e saj është ndërtuar në katin e sipërm me mure qerpiçi dhe skelet druri ku shkarkonte dhe ngarkesa e çatisë me konstruksion druri dhe në katin përdhe muraturë guri me gjerësi 80 cm. Qerpiçi lidhet me llaç balte përzier me kashtë.

Themelet ndërtohen me gurë lumi e lidhen me llaç balte, ngrihen rreth 30-40 cm nga niveli i tokës dhe mbi to vendoset brez druri dhe muret. Çatia ka konstruksion të dendur druri me lartësi kulmi mbi 4 m dhe të mbuluar me tjegulla vendi.

Ndërkati është kryesisht konstruksion druri me dysHEME – tavan dërrase, ku në pjesën me të madhe tavanet janë të dekoruar me dru apo strukture alliçie, mbështetur në tavan me listela dërrase të mbërthyer me tako druri në strukturën e çatisë.

Në mënyrë të përmbledhur materialet origjinale të konstruksionit të ndërtesës mbeten:

- Themele të vazhduara gur lumi dhe lidhes me llaç balte,
- Fasada gur gelqeror i punuar për qoshet dekorative, çatmja e përbërë nga dërrasa dhe kolonçina e trare druri horizontale, mure qerpiçi me elemente diagonal në katin e parë.
- Dyer dhe dritare druri
- Struktura vertikale, muratura e brendshme mur guri, mure qerpiçi dhe mikse me qerpiç dhe elemente diagonal druri, çatmaja e përbërë nga dërrasa dhe kolonçina me trarë druri, horizontale, vertikale dhe diagonal.
- Konstruksion i çatisë dhe ndërkartet me trarë druri dysHEME dërrase, tjegulla vendi për mbulim,
- Kati përdhe, pllaka guri në disa ambiente të shtruara dhe dysHEME dërrase,
- Lidhësi me përbërje balte, gëlqere, kashte dhe rërë.

### **1.3.4 Gjendja ekzistuese**

Aktualisht nga vëzhgimi visual në objekt vërehet që në katin përdhe kemi përgjithsisht struktura me murature guri, muratura e qerpiçit dhe çatmasë.

Ndërhyrjet ndër vite dhe pse janë munduar të respektojnë strukturën ekzistuese të ndërtesës përsëri kanë bërë ndryshime të konstruksionit, si eliminimi apo shtimi i disa mureve ndarëse, i cili vetem pas zhveshjeve të suvave mund të gjykohet për shkallën e degradimit dhe mënyrën e konservimit të tyre. Këto ndërhyrje kanë bërë ndryshime dhe në skemën funksionale të qarkullimit nëpërmjet ndryshimit të pozicionimit të shkalleve. Në një vështrim të përgjithshëm objekti nuk paraqet dëme thelbësore të vetë konstruksionit, por ka një miks strukturash mbajtëse që kanë një reagim të ndryshëm në nivel sigurie. Dëmtimet me të medha i perkasin sipërfaqeve në fasada edhe në dekor. Ka dëmtime të mureve të qerpiçit të dukshme në fasada në pjesën jugore. Ka dëmtime të rifiniturave taveve dhe dysHEMEVE. Duhet theksuar se termeti i vitit 2019 ka lënë disa gjurme dëmtimesh në muraturë por kryesisht me rënie të suvave apo çarje të tyre. Gjithsesi një vlerësim me i thelluar duhet të realizohet. Aktualisht sistemi elektrik dhe hidraulik është i gjithi për t'u ritrajtuar, kjo në funksion dhe të objektit pasi është I gjithi jashtë funksionit. Më poshtë japim në mënyrë me të detajuar problematikat sipas zonave lokale:

- Në katin përdhe të banesës konstatohet tavan druri i thjeshtë me çibukë me dëmtime të elementeve dyer dritare të brendshme dhe dollape muri prej druri gjithashtu të dëmtuara. Dera

kryesore e hyrjes për në objekt është dru i dekoruar, dyshemeja me pllaka granili të kuqërremta të borduruara me pllakë të dekoruar, paraqet dëmtime të pllakave deri në thyerje apo fuga të dëmtuara.

- Suvaja në pjesë të konsiderueshme, paraqet dëmtime dhe lagështirë të dukshme në faqet që dalin jashtë fasade, ku edhe në fasadë degradimi është i dukshëm për shkak të mungesës dhe të ullukeve të shkarkimit të ujërave të shiut,
- Elementet drusorë në përgjithësi paraqiten të dëmtuar,
- Vihet re shtrimi me pllaka i një kohe të mëvonshme, të llojit gres porcelanat dhe tavane gipsi me trarë dekorativë druri, për shkak të përdorimit të strukturës në periudha të ndryshme kohore. Një ndër ambientet e katit përdhe është veshur me pllaka majolike pasi është përdorur për kuzhine bar restoranti.
- Konstruksioni i çatisë i cili është tejet i rëndësishëm paraqitet i dëmtuar dhe i degraduar edhe pse cedime në sipërfaqen e përgjithshme nuk vihen re. Trarët përbërës të strukturës së çatisë kanë degradim të dukshëm si rezultat i ekspozimit ndaj ujërave. Gjithsesi gjendja definitive e çatisë do të përcaktohet pas hapjes së plotë të saj.
- Ndërkatet paraqiten me problematika të qëndrueshmerisë apo dhe kontrollin e tyre. Ka elemente të degraduar druri në dysheme. Të gjithë trarët e ndërkateve duhet t'i nënshtrohen kontrollit dhe ndërhyrjeve restauruese tërësore.
- Strukturat ekzistuese të lehtësuara të cilat përfshijnë të gjithë muratureën prej çatmaje dhe që janë në fasadë apo ndarëse të mjediseve, për vete teknikën ndërtimore duhet të rishikohen, të kontrollohen dhe restaurohen. Në to vërehen shenja të degradimit prej lagështisë, prezence vegjetacioni në lartësi, rënie suvaje dhe degradim të strukturës mbajtëse të drurit.
- Rifiniturat në përgjithësi kanë degradime të dukshme
- Elementet drusore dyer, dritare, dollape muri, sergjen, tavane të dekoruara ose jo, paraqesin degradime dhe kanë nevojë për zvendesime në fragmente të caktuara, por në përgjithësi i gjithë materiali drusor mund të restaurohet me kujdes me qëllim ruajtjen e elementeve origjinale.
- Ka rënie të xhamave, prishje të strukturave të vetratave apo dritareve, shenja lagështie në dyer e dritare, të cilat duhet t'i nënshtrohen restaurimit.

## **2.Kërkesa projektimi të përgjithshme për reastaurimin dhe muzealizimin e godines, si dhe specifikime të projektit.**

### **2.1 Të përgjithshme**

Bashkia e Tiranës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Promovues, kërkon të Krijojë Muzeun METi “Muzeun Etnografik të Tiranës”, duke synuar kështu krijimin e një Muzeu Historik Bashkëkohor, unik në llojin e tij për sa i përket trashëgimisë, subjektit, misionit, konceptit dhe arkitekturës.

Qëllimi kryesor është të përfitohen me realizimin e këtij projekti koncepte bashkëkohore dhe visionare për ndërhyrje të karakterit arkitekturor dhe restaurues për rehabilitimin dhe adaptimin e objektit ekzistues me status Monument Kulture i kategorisë së Parë, si dhe ndërhyrje rijetëzuese muzealizuese të propozuara për funksionin që pritet të ketë, dhe krijimin e një hapësire të re kulturore të shtuar në kryeqytet, i harmonizuar me zonë perreth.

Konsulenti duhet të hartojë një plan masash për të kryer ndërhyrje restauruese dhe konservuese në godinën e Sarajeve, si edhe muzealizimin (të projektojë ndarjen e hapësirave të brendshme muzeale) për të krijuar një ambient miqësor për turistët, me tematika të ndryshme që lidhen me etnografinë në zonën e Tiranës. Brenda këtij kuadri kërkohet që të projektohet një muze etnografik me standarte europiane që t'i përgjigjet një numri gjithnjë e në rritje të vizitorëve në kryeqytet nga e gjithë bota si edhe i një hapësire që nxit interesin e qytetarëve për historinë, trashëgiminë kulturore dhe nxit pjesëmarrjen ndërvepruese të tyre.

Në përgjithësi, objektivi i kësaj konsulence është të mbështesë zhvillimin e një produkti turistik dhe të shtojë hapësirat kulturore në kryeqytet, që të inkurajojë turistët të qëndrojnë më gjatë dhe të kenë një ofertë kulturore të një spektri sa më të gjerë në Tiranë.

Konceptet e ndërhyrjes duhet të bazohen në parime të cilat gjenerohen duke identifikuar karakteristikat arkitekturore, trashëgiminë, vlerat kulturore, historike dhe arkeologjike të zonës dhe përreth saj, si dhe nga eksperiencat me të mira kombetare dhe ndërkombëtare, duke priorizuar vlera në arkitekture, si dhe kualitete shumë të larta projektimi.

Principet kryesore të ndërhyrjes:

- Krijimi i një hapësire të re civile që të sigurojë interesin e njerëzve për trashëgiminë kulturore dhe pjesëmarrjen ndërvepruese të tyre.
- Transformim i Muzeut si pikë tërheqëse për aktivitete të ndryshme që mund të përfshihen në program (bar i hapur, hapësirë recreative, hapësirë pushimi, hapësira edukimi etj.
- Rehabilitim dhe projektim i ri i oborrit rreth muzeut.
- Restaurimi i elementeve origjinale, si tavanet e drurit, dritaret e drurit, oxhaqeve, hamamit, **catia** etj.
- Rikonstruksioni i disa elementeve origjinale të cilët janë demoluar ose transformuar,
- Integrimin visual dhe Teknik të pajisjeve teknike të nevojshme për ndërhyrjet restauruese dhe transformuese të objektit.
- Punet restauruese dhe rikonstruktuese duhet të jenë një shembull i restaurimit profesional, I realizuar nga eksperte artizanë duke përdorur materiale tradicionale dhe **teknikën** tradicionale për këte kategori.
- Zevëndësimin e të gjithë elementeve jo origjinale me elementet origjinale element që bazuar në materialet arkivore grafike e fotografike ti rikthehen formës origjinale të objektit.
- Lidhje e projektit dhe hapësirës me planet zhvillimore të zonës, (PPV dhe PDV) mundësinë e lidhjes me pedonale e Tiranës, Muzeun Besa dhe të gjithë hapësirën përreth.

## 2.2 Funkcionet e reja

Të merren në konsideratë minimalisht funksionet që do të zhvillohen në muzeun e ri, në objektin ekzistues, por jo të kufizuara vetëm në to:

### *Aktivitetet kryesore*

- Aktivitetet në lidhje me ekspozita të përhershme dhe të përkohshme:
- Hapësirë kushtuar Veprimtarive Kulturore
- Hapësira e Qendrës së Dialogut
- Hapësirë e dedikuar për ekspozitën e përhershme
- Hapësirë e dedikuar për ekspozitën e përkohshme
- Hapësira për zhvillimin e prezantimeve institucionale dhe publike (auditori)
- Workshop – Hapësirë Edukativ

### *Aktivitetet mbështetëse*

- Zona e pritjes



- Qendra e Informacionit/ Zona e Biletarisë
- Hapësirë rekreative
- Hapësirë leximi
- Dyqani i Muzeut
- Dyqan kafeje
- Garderobë
- Nyja sanitare
- Hapësirë ndihmëse
- Hapësira administrative | kabinetet dhe funksionet e tyre utilitare
- Arkivi i përhershëm i koleksionit
- Arkivi i përkohshëm
- Hapësirë ruajtjeje
- Hapësira e Kontrollit Teknik
- Hapësira Teknike

### 2.3 Restaurimi

- Projekti i restaurimit të pjesës së jashtme të godinës duhet të sigurojë ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbane dhe mjedisore të qendrës historike të qytetit të Tiranës.
- Fasada e objektit: Ndërhyrjet restauruese në fasadën e objektit, duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të nxjerrin në pah vlerat e tij në vëllim dhe në pamjen e jashtme. Analiza të kushteve ekzistuese, projektit të konsolidimit, restaurimit dhe propozimit për forma më interaktive të komunikimit (projeksione të animuara);
- Pikturat murale (nuk ka), në intërier edhe në fasadë;
- Elementët e drurit, në interier edhe në fasadë;

### Oborri dhe ambjentet përreth

- Oborri duhet të trajtohet në tërësi e elementëve të tij. Ekipi i projektimit duhet të marrë në konsideratë një koncept të ri për këtë fushë.
- Rivitalizimi i oborrit dhe ambientit përreth, studimi i hapësirave dhe kapaciteteve të mundshme.
- Propozim për krijimin e kapilarëve komunikues urban, midis Muzeut dhe hapësirës së këmbësorëve në jug, pedonale së Kalasë së Tiranës, në veri, si dhe bulevardit Jean D'Arc.
- Të merret parasysh se e gjithë zona është në një zonë të mundshme arkeologjike.
- Restaurimi i mureve perimetrale prej guri dhe qerpici; Restaurimi i shtrimit me kalldrëm; Restaurimi i portës së hyrjes ose riprodhimi sipas origjinalit.
- Strukturë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara.

### 2.4 Dimensionet e reja falë teknologjive të reja

Muzeu tradicional i historisë grumbullon kryesisht artefakte, të cilat i tregohen publikut për të paraqitur episode të ndryshme të historisë. Muzetë bashkëkohorë mbështeten nga teknologjitë e reja për të ofruar informacion plotësues për artefaktet duke u lejuar vizitorëve të eksperimentojnë në të njëjtën kohë lloje të tjera eksperiencash. Disa nga teknologjitë e reja që mund të përdoren në muzeun e ri janë:

- Realiteti i Shtuar (AR) dhe Realiteti Virtual (VR);
- Përvojë gjithëpërfshirëse;
- Pajisjet interaktive.



## **2.5 Linja të shumta interpretimi për grupe të ndryshme të synuara**

Muzeu Etnografik duhet të tërheqë dhe të jetë në gjendje të komunikojë me një audiencë sa më të gjerë të mundshme. Kjo audiencë formohet nga individë që kanë formim kulturor shumë të ndryshëm, interesa të ndryshme dhe reagojnë nga lloje të ndryshme stimuluesh. Audiencia e mundshme mund të grupohet në disa grupe të synuara që ndajnë një interes të përbashkët. Për të arritur të gjitha këto grupe të ndryshme ekspozita nuk duhet të ketë vetëm një sistem interpretimi, por disa mekanizma të ndërthurura që nxisin vëmendjen, kuptimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme.

Një listë paraprake e grupeve të synuara janë:

1. Moshë: 1.a. Fëmijët / 1.b. Të rinjtë / 1.c. Të rriturit / 1.d. Të moshuarit
3. Grupe të veçanta: 3.a. Personat e verbër / 3.b. Personat me aftësi të kufizuara

## **2.6 Koha e kaluar gjatë vizitës**

Vizitorë të ndryshëm planifikojnë të kalojnë periudha të ndryshme kohore gjatë vizitës në muze në bazë të shumë faktorëve të tillë si interesi i tyre kulturor dhe sasia e kohës së lirë që kanë planifikuar të kalojnë në Tiranë. Ekspozita duhet t'u sigurojë të gjithëve një përvojë të pasur dhe interesante pavarësisht nga koha e kaluar në muze.

Si rrjedhim, ekspozitat duhet të planifikohen sipas dy kohëzgjatjeve të vizitës: vizitë e shpejtë (rreth 1 orë), vizitë e ngadaltë (rreth 2 orë ose më shumë).

## **2.7 Program Edukues i Integruar**

Muzeu duhet të ketë hapësira të përhershme edukuese për të zhvilluar programe edukative. Ato duhet të konceptohen si hapësira multifunksionale të pajisura me projektorë për materiale audio-vizuale dhe punishte për punime të kryera me dorë. Pavarësisht nga niveli i njohurive të secilit grup, programi edukativ duhet të jetë një vend reflektimi, takimi dhe debati.

Muzeu Etnografik duhet të bëhet një qendër kulturore dhe qendër takimesh për Tiranën.

## **3. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventive**

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar, si dhe të gjithë kërkesave të kategorisë së Monemunteve të Kulturës, dhe kërkesave të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur në Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim, në E-Albania (sipas zbatimit të VKM 216, datë 13.04.2023, si dhe të gjithë analizat për këtë kategori punimesh të referuara dhe me objekte të ngjashme të këtij lloji.

Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manuale, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do ti bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe eficientë e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/ Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

Të gjithas specifikimet dhe llogaritjet do të dërgohen gjithashtu për miratim pranë Insitutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

## 4. REALIZIMI I PROJEKTIT

Në këtë kuadër konsulenti duhet të:

**Faza A:** Të krijojë një projekt/koncept, duke i dhënë përparësi ndërhyrjes restauruese-konservuese, si dhe të përgatisë një plan zhvillimi/biznesi.

Konsulenti do të kryejë aktivitetet kryesore të mëposhtme për shërbimet e projektimit të fazës së parë:

**Detyra 1:** Një përmbledhje e të gjithë informacionit të nevojshëm, duke përfshirë **inventarizimin, përgatitjen e një plani pune dhe përgatitjen e raportit fillestar.**

**Detyra 2:** Zhvillimi i Konceptit të Muzeut Etnografik, duke përcaktuar produktin turistik dhe maksimalizuar përfitimet nga ky investim që do të financohet nga Bashkia Tiranë.

**Detyra 3:** Projektimi paraprak i konceptit, vlerësimet paraprake.

**Detyra 4:** Përgatitja e projektit të detajuar, listën e materialeve dhe shërbimeve të nevojshme, specifikimet teknike, raportet teknike, raportet e VNM-së, planet e menaxhimit dhe planin e punimeve.

### 1. **Faza A:** Shërbimet e Projektimit

Hapat që do të ndërmerren për shërbimet e projektimit:

#### **Detyra 1 - Inventarizimi dhe fillimi:**

- Rishikoni objektivat e përgjithshme të konsulencës.
- Konsultohuni me listën e dokumenteve të disponueshme të identifikuar nga BT. Krahas kësaj identifikoni të gjithë hartografinë, planet, literaturën teknike dhe historike dhe "idetë e projektit" që mund të qëmtoni në burime të ndryshme. Theksoni rëndësinë e tyre në këtë detyrë.
- Identifikoni ligjet e përgjithshme, rregulloret, udhëzimet vendase dhe ndërkombëtare që veprojnë dhe rregullojnë menaxhimin e monumenteve të kulturës, muzeve, çështjeve mjedisore, etj.
- Identifikoni hartat, fotot dhe materialet e vjetra arkivore që lidhen me ndërhyrjet e kohëpaskohshme në ndërtesë.
- Konsulenti do të kryejë një vlerësim fillestar dhe analizë të gjendjes aktuale të objektit ku të paraqiten dhe shkaqet dhe shkalla e degradimit të objektit që të kryejë më pas konsulencën e projektimit për restaurim-konservimin dhe muzealizimin e objektit.
- Njihuni me investimet e tjera të kryera në muzetë etnografikë në vend ose çdo propozim ekzistues për muzealizim. Theksoni rëndësinë e tyre në këtë detyrë dhe kryeni studim të mëtejshëm nëse gjykohet e nevojshme.
- Përvijoni një plan pune që përshkruan rradhën e punëve sipas prioriteteve të ndërhyrjes në objekt, metodologjinë, afatin kohor, burimet e dedikuara. Specifikoni ekipin që do të punojë në këtë proces.
- Identifikoni rreziqet e mundshme dhe përvijoni një strategji për angazhimin e palëve që duhet të përfshihen në këtë proces.
- Rishikoni nëse është e nevojshme komponentët teknikë dhe fushëveprimin e TOR.

**Materiale për t'u dorëzuar:** Raport fillestar që detajon çështjet e sipërcituara, me fokus të veçantë në Planin e Punës dhe strategjinë e angazhimit për palët e interesuara, detyrat dhe shpërndarjen e stafit/burimeve për zhvillimin e shërbimeve të projektimit sipas kësaj detyre.

## Detyra 2: Zhvilloni konceptin e Sistemit të Muzeut

Konsulenti do të kryejë një vlerësim dhe analizë në objektin e “Sarajeve”, duke identifikuar dhe hartuar/regjistruar asetet/objektet/vlerat e tij kulturore materiale dhe jomateriale (vepra, artefakte, mentifakte, ekzemplarë, dokumente arkivore, dëshmi, etj.) sipas nevojës përcaktuar nga fushëveprimi i konsulencës. Vlerësimet do të kërkojnë mobilizimin e ekipit në terren dhe komunikimin me listën e identifikuar të palëve që duhet të angazhohen, për të konfirmuar dhe zgjeruar ushtrimin e inventarizimit të kryer sipas Detyrës 1.

A. Vlerësimi dhe analiza në zonën e studimit duhet të përfshijë, por jo të kufizohet në sa vijon:

- Vlerëson dhe analizon muzetë etnografikë ekzistues, tashmë funksionalë në Shqipëri (të hapur për vizitorët), pa u kufizuar në:

- Statusin aktual, si pronësia, modeli i funksionimit, struktura e menaxhimit, pasqyrat financiare, qëndrueshmëria, numri i vizitorëve, etj.
- Kushtet strukturore ekzistuese të muzeve (p.sh. struktura, energjia elektrike, sistemi i ngrohje-ventilim, lagështia, etj) funksionalitetin dhe cilësinë e shërbimeve ekzistuese brenda muzeve (p.sh. shërbimet sanitare, shërbimet për pritjen e vizitorëve, sinjalistika e nevojshme për kalimet e vizitorëve që nga hyrja deri në daljen nga objekti, shërbime të tjera që ofrohen në ambientet e tyre si dyqan suveniresh, kafeteri, etj).
- Interpretimin e fondit të ekspozuar, përvojën e vizitorëve, mjetet/teknikat e marketingut të përdorura për të promovuar muzeun, sistemin fizik dhe operacional, etj.

- Vlerëson dhe harton përmbajtjen historike për pasuritë/objektet e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale (vepra, arte-fakte, ekzemplarë, dokumente arkivore, dëshmi), në konsultim me Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe subjektet e tjera përgjegjëse.

- Harton strategjinë e promovimit të Muzeut Etnografik si edhe integrimin e tij në itinerare turistike locale, kombëtare dhe rajonale.

- Kryen konsultime me agjencitë teknike dhe ekonomike, palët përkatëse të interesit dhe përfaqësues nga komuniteti dhe sektorët private, organizata joqeveritare lokale, për të mbledhur të dhëna dhe informacione në kuadër të kësaj detyre.

- Analizon të gjitha ligjet/udhëzimet ekzistuese, p.sh. rregulloret dhe udhëzimet kombëtare në lidhje me trashëgiminë kulturore, koleksionet muzeale, ligjet e menaxhimit të muzeut që zbatohen në zonën e studimit dhe çdo kufizim/analizë mjedisore, çështjet sociale, ekonomike, kulturore dhe menaxheriale nga lista e palëve të interesuara të identifikuara, që lidhen me qëllimin e kësaj detyre.

- Vlerësoni dhe hartoni të gjitha të dhënat e disponueshme lidhur me fluksin dhe tendencën turistike, aktivitetet/shërbimet ekonomike që zhvillohen në zonën e studimit dhe konsultohuni me gjetjet e konsulencës së Kërkimit të Tregut, se si ato lidhen me qëllimin e kësaj detyre.

B. Bashkia Tiranë ofron një listë referimi të ligjeve/rregulloreve që do të merren parasysh (pa kufizuar) nga Konsulenti gjatë zhvillimit të kësaj detyre. Për më tepër, Konsulenti duhet të konsultohet dhe vlerësojë për të shqyrtuar idetë e studimeve dhe projekteve të planifikuara

për t'u zhvilluar nga Bashkia e Tiranës, Ministria e Kulturës, etj., në mënyrë që të shmanget shpërdorimi i fondeve përmes rritjes së shpenzimeve apo moskoordinimi i kësaj konsulence. Procesi duhet të përfshijë gjithashtu mekanizma të fortë konsultimi gjatë të gjitha fazave të konsulencës me të gjitha grupet e interesit.

- C. Konsulenti në bazë të rezultateve të vlerësimit dhe analizës së kryer do të vazhdojë vlerësimin e tij dhe **do të propozojë një projekt për muzealizimin**. Konsulenti do të identifikojë një listë investimesh dhe aktiviteteve që synojnë të përmirësojnë dhe plotësojnë këtë koncept/vizion. Projekti i muzealizimit do të identifikojë, përshkruajë dhe konceptojë sistemin e brendshëm të ndarjes së hapësirave në bazë të tematikave të ndryshme të konceptuara dhe do të përcaktojë informacionin e nevojshëm që do të përdoret në këto ndarje. Projektet apo aktivitetet e investimeve shtesë duhet të kenë prioritet aplikimin e metodologjive dhe kriterëve të qarta të bazuara në vlera të forta kulturore, elemente teknike, financiare, mbrojtëse dhe qëndrueshmërie, etj. dhe si ato kontribuojnë në rritjen e ofertës turistike dhe përvojës turistike/vizitore në muze dhe në qytet.
- Konsulenti gjithashtu do të identifikojë dhe propozojë një projekt investimi me ndikime minimale mjedisore dhe sociale.

### **Materiale për t'u dorëzuar:**

- 1. Raporti i vlerësimit dhe analizës**, do të dorëzohet në formën e një raporti me shkrim, i mbështetur nga harta, skica, etj. që dokumentojnë qartë hetimin e kryer në terren dhe më gjerë nga Konsulenti, duke synuar një orientim më të mirë të vendimmarrjes/validimit të proceseve të kësaj konsulence.
- 2. Një raport** me shkrim i përbërë nga (pa u kufizuar në):
  - Koncepti/Projekti I MET, duke përfshirë listën e elementeve:
    - (i) Raporti do të përfshijë harta, skica dhe çdo të dhënë tjetër vizuale që përputhet me një kuptim më të plotë të organizimit hapësinor dhe fizik midis elementeve të ndryshëm që përcaktojnë Koncept/Projektin.
    - (ii) Listimi i masave afatshkurtra dhe afatgjata (p.sh. rregulloret/ligjet, iniciativat publike, stimujt, etj.) dhe veprimet (p.sh. ndërhyrjet konkrete, mjetet e menaxhimit, plani i integruar i komunikimit të marketingut, etj.) që ndikojnë dhe kontribuojnë në arritjen e konceptit të MET.
  - Lista e investimeve/aktiviteteve, duke përfshirë metodologjinë dhe kriteret e përdorura për identifikimin e tyre.
  - 3 alternativa të paketave të investimeve dhe analiza SËOT që do të ndërtojnë arsyetimin për çdo propozim. Çdo alternativë duhet të shoqërohet me një përshkrim, së bashku me një shënim përmbledhës të përgjithshëm duke përfshirë rekomandimin e Konsulentit për alternativën e renditur më lart.
- 3. Workshop Konsultativ:** Një Prezantim në PowerPoint, për të paraqitur (i) situatën aktuale bazuar në vlerësimin dhe analizën e kryer; (ii) Projektet e MET me elementet e tyre përbërës; (iii) listën e përmbledhjeve të investimeve/aktiviteteve; (iv) tre alternativat e propozuara të paketave të investimeve. Konsulenti mund të marrë në konsideratë përdorimin e materialeve

mbështetëse që ndihmojnë në kuptimin dhe vizualizimin më të mirë të koncepteve për propozimet;

4. **Raporti i Validimit:** Në formën e një raporti me shkrim, Konsulenti do të regjistrojë/reflektojë diskutimin dhe rezultatet e procesit të vizionimit, konsultimeve dhe arsyetimit për përzgjedhje (kundrejt opsioneve të tjera që janë shqyrtuar, por nuk janë përzgjedhur). Pjesëmarrja e stafit është e nevojshme në seminarin e palëve të interesuara dhe konsiderohet pjesë e rezultateve. Rezultatet përfundimtare do të marrin në konsideratë të dhënat dhe kërkesat e Bashkisë Tiranë duke prodhuar versionin përfundimtar, përpara se të vazhdohet në fazën tjetër.

### **Detyra 3: Projektimi paraprak i konceptit, vlerësimet paraprake**

Konsulenti do të zhvillojë projektin konceptual paraprak për secilën hapësirë brendamuzeale duke përfshirë sipas nevojës dhe pa u kufizuar në:

- (i) Arkitekturën e muzeut.
- (ii) Ndërhyrjet në infrastrukturë publike.
- (iii) Vlerësimet paraprake të kostos për secilin nga investimet e propozuara (duke mos kaluar tavanin e fondeve).

1. Vizualizoni konceptin përmes (por pa u kufizuar në): skica dhe vizatime konceptuale, identifikoni ndërhyrjet konservuese dhe adaptive në strukturat e vjetra, vizualizimin 3D, etj.;  
**Paraqitja dhe seksionet/lartimet/detajet përkatëse:** Vizatimet duhet të paraqiten në shkallën e duhur (p.sh. për detaje të sakta duhet të jenë nga 1:1 deri në 1:25, për infrastrukturën dhe planifikimin e ndërtesave/fasadat për projektin e objektit, vizatimet duhen për të siguruar lexueshmërinë dhe saktësinë teknike, duke treguar karakteristikat hapësinore dhe funksionale të ndërhyrjeve dhe integrimin e saj në kontekstin urban/natyror. Për të zhvilluar propozime të sakta, Konsulenti do të marrë në konsideratë kryerjen e anketimeve të nevojshme në terren (ose hetime të tjera mbi masat mbrojtëse, etj.) për secilën alternativë, në mënyrë që konceptet paraprake të propozuara për çdo tipologji projekti të jenë të bazuara dhe mos të komprometojnë asnjë vendimmarrje në këtë fazë.
2. **Të sigurojë të gjithë personelin, materialet, pajisjet dhe të gjitha sendet e tjera të një natyre të përkohshme që kërkohen për ekzekutimin dhe përfundimin e punimeve që lidhen me krijimin e një përmbajtjeje për interpretim multimedial sipas kontratës dhe këtij kuadri të kërkesave.**
3. Kontraktuesi do të marrë masat adekuate për sigurinë e personelit të angazhuar. Kudo që nevojitet, e gjithë përmbajtja dhe rezultatet e arritura do të konsultohen me rregulloret kombëtare aktuale dhe kur është e nevojshme do të miratohen nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore apo Këshilli Kombëtar i Muzeve.
4. Konsulenti duhet të ndërlidhet me një krijues të konceptit të përmbajtjes (konsulent projektimi/dizajner).
5. Metodologjia e punës së konsulentit dhe programi I punimeve duhet të bëjë të mundur që punimet të mbarojnë sipas parashikimeve.
6. Konsulenti do të marrë në konsideratë hartimin e propozimeve për investime deri në tavanin e fondeve të disponueshme të investimit të alokuara për këtë projekt, për qëllime ndërtimi përfundimtare prej LEK (me TVSH).
7. Do të ketë diskutime dhe raportime të rregullta ndërvepruese ndërmjet Ekipit të Konsulentit dhe Bashkisë Tiranë për të rishikuar dhe përmbushur standardet e kërkuara për konceptet

paraprake dhe kostot e vlerësuara për çdo investim. Për të gjitha raportet e dorëzuara për propozimet do të kërkohet gjithashtu edhe plani i zbatimit të tyre, që do të vlerësohen dhe miratohen nga Bashkia Tiranë.

### **Materiale për t'u dorëzuar:**

- Çdo dosje e projektit investues do të përfshijë: projektet paraprake konceptuale, raportin teknik, vlerësimet paraprake të kostos.

Raporti i Validimit: Në formën e një raporti me shkrim, Konsulenti do të regjistrojë dhe pasqyrojë diskutimin dhe rezultatet e procesit të konsultimeve, si dhe arsyetimin e ndjekur për reflektimet dhe përzgjedhjet e bëra (përkundrejt opsioneve të tjera që janë shqyrtuar, por nuk janë përzgjedhur). Pjesëmarrja e stafit është e nevojshme në seminarin e palëve të interesuara dhe konsiderohet pjesë e rezultateve.

### **Detyra 4: Përgatitja e projektit të detajuar, lista e materialeve dhe shërbimeve të nevojshme, specifikimet teknike, raportet teknike, raportet e VNM-së, planet e menaxhimit dhe të punimeve.**

1. Bazuar në parashikimet e projektit të rënë dakord, Konsulenti do të zhvillojë, por pa u kufizuar në:
2. Sondazhe dhe rishikim të projekteve paraprake: për të përcaktuar qëllimin e detajuar të projektit dhe për të përcaktuar kufijtë e veçantë të projektit. Kjo mund të përfshijë aktivitete të tilla si: (i) rishikimi i dizajnit dhe vizatimeve nga konsultimet e kaluara të Projektit-Ide paraprak dhe pasqyrimi i modifikimeve/komenteve të nevojshme për këto vizatime dhe specifikime kur është e nevojshme; (ii) kryerja e sondazheve të detajuara në terren, studimi gjeologjik dhe sizmik, duke përfshirë studime inxhinierike dhe arkitekturore të hapësirave publike përreth, ndërtesave/fasadave të identifikuara duke përdorur metoda tradicionale dhe ato teknologjike të avancuara si skaner lazer 3D, etj. më shumë saktësi; (iii) mbledhjen e mëtejshme të të dhënave, hetime/vlerësime të hollësishme dhe analiza për dizajne të detajuara dhe aktivitete të objektit.
3. Dosja e plotë e projektit duhet të përmbajë (por nuk kufizohet në): Dizajnin e detajuar të projektit: Kjo përfshin të gjitha punët e kërkuara me qëllim të prodhimit të një grupi të plotë dokumentesh tenderimi. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në: (i) dizajne të detajuara (zhvillimi i projekteve arkitektonike dhe inxhinierike, elektrike, hidro-mekanike, MNZ);(ii) projekti i rehabilitimit të infrastrukturës së monumentit/objektit etj. dhe specifikimet teknike duke përfshirë të gjitha mbledhjet e nevojshme të të dhënave, anketat dhe analizat për të mbuluar të gjitha aspektet e dizajnit me detaje; (iii) metodologjia e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese në monument; (iv) specifikimet teknike; (v) raportet teknike; (vi) faturat e sasive - BoQ (me çmim dhe pa çmim), (vii) plani i punës dhe përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe preventivat përkatës. Vizatimet e projektimit të detajuar do të përgatiten në bazë të miratimit të projekteve të koncepteve paraprake.

**Projekti i projektimit të ekspozitave të muzeut:** Bazuar në konceptet e muzeut, Konsulenti do të përgatisë ekspozitat e detajuara të muzeut për çdo hapësirë brenda projektit të investimit. Ekspozitat e Detajuara të Muzeut (EDM) duhet të përfshijnë:

- Qëllimin i ekspozitave: Konsulenti do të detajojë në konsultim me Bashkinë Tiranë dhe palët përkatëse të interesuara: (i) Deklaratën e Misionit të Muzeut, (ii) Deklaratën e Misionit të Ekspozitës dhe (iii) Programet e Ekspozitave. Në deklaratën e misionit, Konsulenti duhet të shprehë qëllimin e muzeut dhe marrëdhëniet e tyre me audiencat e ndryshme. Fokus të veçantë do të ketë edhe në identifikimin, ekspozimin dhe interpretimin e koleksionit të muzeut, ruajtjen, ekspozimin dhe studimin e tij. Përveç deklaratave të misionit, Konsulenti do të përcaktojë deklaratat e qëllimit. Këto deklarata theksojnë rëndësinë e ekspozitave si një mjet edukativ si për vizitorët edhe studentët. Konsulenti do të propozojë udhëzime për stafin menaxhues të muzeut mbi Programin e Ekspozitave, duke përfshirë ekspozita të përhershme dhe të përkohshme.
  - Përmbajtja e detajuar e ekspozitave të përhershme dhe ekspozitave të para të përkohshme: Konsulenti do të detajojë përmbajtjen e ekspozitës së përhershme dhe ekspozitave të para të përkohshme (nëse ka pjesë të programit të vitit të parë). Ekspozitat do të përfshijnë (por pa u kufizuar në) artefakte nga koleksioni i muzeut, instalime video, instalime zanore, performanca, tregime, etj. Konsulenti do të përgatisë kontekstin bazuar në konceptin e muzeut për të rrëfyer historinë për audiencën e përzgjedhur dhe për të shpjeguar artikujt që shfaqen. Teksti, dioramat, diagramet, hartat dhe ekranet interaktive do të përdoren për të ofruar shpjegimin e nevojshëm të sfondit dhe koncepteve.
  - Struktura organizative dhe rolet: Ky seksion do të përcaktojë se si organizohet muzeu për të kryer planet dhe projektet e ekspozitave në hapat e hershme të muzeut: si gjenerohen idetë, si zgjidhen ekspozitat për zhvillim, si caktohet stafi për projektet e ekspozitës, dhe kush është përgjegjës për menaxhimin e projektit.
4. Planet e mirëmbajtjes: Konsulenti do të zhvillojë gjithashtu një libër udhëzues për çdo projekt investimi që përmban lista specifike të detajuara të udhëzimeve se si të mbahet çdo komponent i një projekti investimi në gjendje të mirë pune, duke ofruar udhëzime mbi “E-pyetjet” e menaxhimit të aseteve. Çfarë: Inventari i aseteve që duhet të mirëmbahen si në interior dhe në eksterier etj ) Si: Llojet e detyrave të mirëmbajtjes (si inspektimi, konservim dhe restaurimi) Kur: Intervalet në të cilat duhet të mirëmbahen çdo aktiv (si p.sh. javore, tremujore, vjetore, etj.), i quajtur edhe orari i mirëmbajtjes. Kush: Nivelet e aftësive të kërkuara për çdo detyrë mirëmbajtjeje. Plani i mirëmbajtjes duhet të japë gjithashtu informacion në lidhje me kostot e mirëmbajtjes së projektit investues.
  5. Miratime specifike: Konsulenti do të përgatisë dokumentet e nevojshme dhe vizatimet e detajuara për miratimet e Autoriteteve Vendore dhe çdo miratim tjetër që kërkohet në proces (d.m.th. miratimet nga agjenci të tilla si Këshilli Kombëtar i Restaurimit, Këshilli Kombëtar i Muzeve etj.). Aprovimet e kërkuara do të identifikohen në planin e punës dhe do të ekzekutohen nga Konsulenti për realizimin e projektit të ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në objekt, duhet të jetë i licencuar në fushën e trashëgimisë kulturore, të lëshuara nga institucionet përkatëse.
  6. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social, Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social: Konsulenti do të përgatisë projekt-Raportet e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social për çdo projekt, i cili do të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar për marrjen e një leje mjedisore apo autorizimi. Raportet duhet të jenë gjithashtu në përputhje me standartet europiane për çështjet që lidhen me Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë në punë dhe duhet të përgatiten nga një ekspert i licencuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (përfshirë licencën e QKL-së dhe ekstraktin e QKR-së).



Draft raportet do të konsultohen nga Njësia Mjedisore dhe Sociale e Bashkisë Tiranë për t'u verifikuar.

7. Paketa e kontratave të punimeve: Konsulenti do të punojë dhe do të dorëzojë projektet e detajuara për të gjitha Kostot totale për projektet e propozuara të investimit nuk do të kalojnë atë që do të ndahet për qëllime përfundimtare të ndërtimit: LEK përfshirë TVSH-në.

Projekti për objektin: ***“Restaurimi dhe Muzealizimi i Muzeut Etnografik, Tiranë”*** duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, pjesa restauruese duhet të kalojë në këto faza:

### **FAZA I Analiza e detyrës së projektimit**

Analiza e detyrës së projektimit/ termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit. Ajo duhet të përfshijë një analizë të argumentuar të çështjeve/ kërkesave kryesore të trajtuara në detyrën e projektimit.

a. Kryerja një studimi gjithëpërfshirës, përfshirë rishikimin e raporteve të inspektimit dhe dokumenteve të tjera përkatëse për secilin objekt. Këto dokumente do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- (i) projektin teknik të gjendjes ekzistuese të objektit si dhe metodologjia e ndërhyrjes konsoliduese në monument, me karakter përforcues, konservues dhe restaurues në zbatim të legjislacionit përkatës në fushën e trashëgimisë kulturore.
- (ii) studime të tjera teknike të disponueshme, sondazhe dhe dokumentacion të punimeve të kaluara në sit;
- (iii) konventat ndërkombëtare, kartat dhe modelet e praktikës më të mirë të ruajtjes në lidhje me detyrën në fjalë;
- (iv) ligjet, rregulloret kombëtare dhe lokale që lidhen me standardet dhe rregullat e ruajtjes për pasuritë e trashëgimisë kulturore në Shqipëri;

b. Të përshkruajë metodologjinë për detyrën, duke përfshirë: fushën e studimeve shtesë që do të bëhen dhe sondazhe përpara zhvillimit të masave konceptuale të ndërhyrjes; si dhe metodologjinë për prioritizimin e ndërhyrjeve si dhe listën e ndërhyrjeve të nevojshme, kostot, metodologjinë dhe caktimin e prioriteteve, identifikimin e kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme për zbatim, ndikimin në vlerën e trashëgimisë dhe një ekzaminim fillestar të masave mbrojtëse që identifikojnë aspektet sociale, mjedisore dhe të qëndrueshmërisë, bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare.

c. Konsulenti pritet të kryejë aktivitetet e mëposhtme duke përfshirë (por jo kufizuar në):

- (i) Në vlerësimin e sitit dhe identifikimin e të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme për ruajtjen dhe konservimin dhe restaurimin e tij;
- (ii) studim në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore të sitit dhe sondazheve

(iii) një studim mjedisor;

(iv) siç do të përcaktohet nga Konsulenti, të kryejë sondazhe dhe vlerësime teknike të kërkuara për të identifikuar rreziqet që prekin sitin (për shembull, rrëshqitjet e tokës, humbje të materialeve, kushtet që shkaktojnë dëme strukturore progresive, etj) dhe vendet që mund të jenë më të rrezikuara. Studimet e kërkuara përfshijnë studime gjeologjike-inxhinjerieke, studim sizmiologjik si dhe studimin inxhinierik të strukturës së monumentit.

Këto studime kanë për qëllim të: rikonfirmojnë fushat me përparësi më të lartë për ndërhyrje urgjente të identifikuara në studimet e mëparshme, si dhe të identifikojnë çdo fushë të re me përparësi shqetësimi për ndërhyrje në një plan afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë.

Gjatë kryerjes së studimeve, Konsulenti duhet të marrë në konsideratë Ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe rregulloret që mbrojnë pasuritë kulturore. Sondazhet në sit mund të përfshijnë teste jo destruktive dhe teste minimale invazive të mostrave të materialit siç kërkohet për hartimin e ndërhyrjeve, pa shkaktuar dëm shtesë ose humbje materiali në sit. Çdo ndërhyrje nevojshme apo sondazh që duhet të bëhet në objekt apo në territorin e tij, nëse konsiderohet e domosdoshme, duhet të marrë më parë miratimin e organeve kompetente në fushën e trashëgimisë kulturore. Materiali për ndërhyrjen duhet të jetë i përgatitur nga persona të licencuar në fushën e trashëgimisë kulturore para se të dërgohen për miratim.

## **FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)**

Bazuar në rezultatet e Analizes Paraprake, Konsulenti do të përgatisë një listë të ndërhyrjeve prioritare. Bazuar në këtë përparësi, projekt-ideja do të hartohet për ndërhyrjet me përparësi (lista e shkurtër) si pjesë e një plani veprimi urgjent. Kjo duhet të përfshijë fusha me përparësi të lartë për të zbatuar një program monitorimi afatgjatë.

Në zhvillimin e opsioneve të ndërhyrjes, duhet të merren parasysh këto: ruajtja e autencitetit të materialit dhe mbrojtja e pasurive kulturore, favorizimi i masave të ndërhyrjes që janë të kthyeshme, dhe ndikimet direkte dhe indirekte në trashëgiminë kulturore për masat e propozuara. Për më tepër, duhet të paraqiten arsye për secilën ndërhyrje të propozuar së bashku me mënyrën se si projekti konsideron statusin, vlerat dhe gjendjen ekzistuese të pasurive të trashëgimisë kulturore të prekura.

Në përgatitjen e modeleve paraprake të konceptit për çdo ndërhyrje të zgjedhur me përparësi (listë e shkurtër), Konsulenti do të marrë në konsideratë pikat si më poshtë (por jo të kufizuar në) për të siguruar prezantimin teknik të përshtatshëm, siç janë:

- I. Modelet paraprake arkitektonike / inxhinierike do të paraqiten me Skica dhe vizatime / vizualizim konceptual 3D, projekt ideja ( inxhinierike dhe arkitektonike) duhet të përmbajë të gjitha ndërhyrjet përforcuese, konsoliduese dhe restauruese të objektit shoqëruar me raporte shpjeguese të metodologjisë së ndërhyrjes në përputhje me legjislacionin e trashëgimisë kulturore;
- II. Planimetritë dhe prerjet gjatësore e tërthore teknike përkatëse / fasadat / detajet duhet të paraqiten në shkallë të përshtatshme vizatimi (psh. 1:50 - 1: 500, etj.). Për detaje të sakta shkallët nga 1: 1- deri në 1:25, etj. Duhet të përdoren për të siguruar lexueshmëri dhe saktësi teknike.
- III. Preventivat Paraprakë;
- IV. Grafiku paraprak i punimeve;
- V. Specifikimet paraprake teknike;

- VI. Raportet teknike paraprake;
- VII. Vlerësimet paraprake të ndikimit në trashëgimi;
- VIII. Vlerësimet paraprake të ndikimit në mjedis dhe social;
- IX. Plani i Punës për punët që do të kryhen për të garantuar sigurinë në vend;
- X. Udhëzim për zbatimin e punëve dhe planeve të mirëmbajtjes;

**Sondazhet Teknike:** Për të prodhuar projektin paraprak arkitektonik / inxhinierik të qëndrueshëm, do të zhvillohen (por jo vetëm): (i) sondazhe shtesë në terren, përfshirë studime inxhinierike dhe arkitekturore në terren, vizatime të dimensionuara të ndërtesave / fasadat / elementet e tjera ku do të ndërhyhet.

Do të ketë diskutime dhe raportime interaktive të rregullta ndërmjet ekipit të Konsulentëve dhe Autoritetit Kontraktor, gjithashtu palë të interesuara (Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Drejtorja Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, etj) dhe të siguroheni që ndërhyrjet e propozuara janë të realizueshme duke marrë parasysh udhëzimet dhe rregulloret që veprojnë si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas këtyre konsultimeve, dokumentet paraprake të konceptit dhe raportimi do të azhurnohen për shqyrtimin përfundimtar deri në miratim.

**Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant- propozime, ku për secilin variant do të dorëzohen:**

- a. Projektet teknike: arkitektonike, konstruktive, elektike, hidroteknike, ngrohje ventilim, MNZ, infrastrukture dhe peizazhi;
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
- c. Preventiv paraprak;

Varianti që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

*Materialet dorëzohen në format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad, excel, ëord etj.)*

### **FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemimit dhe i integritit)**

**Dorëzimi:** Konsulenti pritet të paraqesë dorëzimet e mëposhtme nën Detyrën 1:

Projekt – Idenë dhe raportet përfundimtare: duke përfshirë të gjitha aspektet e listuara në paragrafët si dhe reflektimin e të gjitha sugjerimeve të bëra nga Këshilli Teknik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Prezantimi (në PP):** Prezantimi i Projekt Idesë dhe Ndërhyrjeve të propozuara. Ky prezantim relatohet gjatë procesit të konsultimit dhe miratimeve të palëve të interesuara ose sa herë që vlerësohet e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor.

**Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së projektimit.**

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt- idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë edhe:

- Projekti arkitektonik dhe projektet inxhinierike (si konstruksioni, ndërhyrjet elektrike, mekanike, mnz etj) të detajuara me vizatime, relacione teknike përkatëse, si dhe metodologjia e ndërhyrjeve konsoliduese dhe restauruese të objektit, të parashikuara në projekt në zbatim të legjislacionit përkatës. Këto projekte të jenë hartuar nga persona të pajisur me liçensa përkatëse sipas legjislacionit në fuqi dhe karakterit të ndërhyrjes.

- Raport teknik;
- Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 216, datë 13.04.2023 për “ Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim ” si dhe Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) ;
- Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 për “ Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim ” dhe të analizave teknike të tyre, si dhe Manualin e cmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- Plan Rilevimi-GIS, i hartuar nga Drejtoria e Kadastrës, BT;

***Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,ëord etj.)***

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhormimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

Projekt ideja paraqitet për shqyrtim e miratim nga organi kolegjal “Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale” (KKTKM) pranë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet sistemit E-leje për shërbimin “Ndërhyrje në Pasuri Kulturore”.

#### **FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.**

**Miratimet dhe Lejet e Detyruara:** Konsulenti përgatit dosjen e dokumenteve, përfshirë vlerësimin e ndikimit në trashëgiminë dhe Projektin e Detajuar të Zbatimit për lejet e detyruara për tu marrë nga organet vendore dhe të gjitha miratimet e tjera të kërkuara në proces (miratimi në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale). Pas miratimit në KKTKM, vijohet procedura e marrjes së lejes sipas legjislacionit të planifikimit të territorit. Miratimet e kërkuara do të identifikohen dhe kryhen nga Konsulenti, për të marrë miratimet dhe për të kompletuar Dokumentat për Tenderim.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit E-Albania, ku ofrohet mundësia e shqyrtimit online, në sistemin elektronik e-lejet, të bashkëpunohet dhe me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

#### **FAZA V: Projekti zbatimi: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.**

**Projekti i Detajuar i Zbatimit:** Konsulenti do të përgatisë si vijon, por pa u kufizuar në: (i) vizatime të hollësishme të projektimit (arkitektonike, inxhinierike, eletrike, etj.) Planet / vizatimet 2D / vizatimet 3D / detajet teknike, specifikimet, relacionet teknike e hartuara me saktësi duke përdorur standardet dhe praktikat më të mira të projektimit të paraqitura në shkallën e duhur të vizatimit (p.sh. 1:50 - 1:500, etj.) Për detaje të sakta duhet të përdoren shkallët nga 1:1 deri në 1:25, etj. lexueshmëria dhe saktësia teknike; (ii) specifikimet teknike që mbulojnë të gjitha aspektet e projekteve të detajuar të zbatimit; (iii) raportet teknike; (iv) preventivat; (v) Grafiku i Punimeve

**Planet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:** Konsulenti duhet të përgatisë draftin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili do të jetë në përputhje me kërkesat legjislative kombëtare për marrjen e një leje mjedisore / autorizim. Draft raportet do të konsultohen nga palët e interesuara.

**Dorëzohet:** Konsulenti do të dorëzojë paketat e punëve bazuar në planin e planifikuar të zbatimit të aprovuar nga Autoriteti Kontraktor, dhe secila paketë e punimeve do të përfshijë për secilin projekt investimi: (i) dokumentacionin e detajuar të projektimit përfshirë vizatimet e planeve / prerjeve tërthore / pamje 3D / detaje teknike / specifikimet teknike bazuar në sondazhet teknike dhe duke përdorur standardet dhe praktikat më të mira të projektimit; (ii) specifikimet teknike përfundimtare; (iii) raportet teknike përfundimtare; (iv) planet e menaxhimit dhe konservimit përfundimtar; (v) metodologjia përfundimtare për priorizimin e ndërhyrjeve, listën përfundimtare të ndërhyrjeve me përparësi dhe planin e veprimit; (vi) preventivat përfundimtarë dhe (vii) vlerësimet përfundimtare të ndikimit mjedisor dhe social. Për detaje të mëtejshme referojuni tabelës së dorëzimeve.

**Prezantimi (në PP):** Prezantimi i Projektit të Detajuar të Zbatimit. Ky prezantim relatohet gjatë procesit të konsultimit dhe miratimeve të palëve të interesuara ose sa herë që vlerësohet e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit duhet të përmbajë:

- Raportet teknike (konstruktiv, arkitektonik, topografik, gjeologjik, sizmik, hidroteknik, historike, arkitektonike, konstruktive, konserim –restaurim, elektrike, hidroteknike, mekanike të ngrohje - ventilim, eficaenca energjitike, MNZ)  
Planvendosjen e punuar sipas GIS dhe formatit te miratuar
- Planimetritë e gjendjes ekzistuese
- Rilevimin topografik
- Projektin arkitektonik
- Projektin konstruktiv
- Raport gjeologo-inxhinierik
- Studimi sizmiologjik
- Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin
- Projekti hidroteknik
- Projektin termoteknik/kondicionimi
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
- Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit, përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;
- Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
- Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve dhe në Plan Sistemin e Objektit;
- Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
- Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrimit tregtar.
- Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit;
- Liçensat përkatëse të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit, sipas fushave përkatëse të hartimit të këtyre projekteve, sipas legjislacionit në fuqi

***Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dëg. , wrd, exel.***

Pas miratimit në KKTKM, vijohet procedura e marrjes së lejes sipas legjislacionit të planifikimit të territorit

## **FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar**

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe VKM NR. 216, datët. 13.04.2023 për “ Sistemit të integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për zërat e Punimeve në Ndërtim”. Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/ modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

**Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme, si dhe bazuar në:**

**Projekt Zbatimi** duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në Ministrinë e Kulturës për të vijuar sipas legjislacionit të planifikimit të Territorit.

| <b>DETYRA</b>  | <b>PËRMBAJTJA</b>  | <b>FORMATI</b>   |
|--|--|--|
| <b>Hartim “Restaurimi i Muzeut Etnografik të Tiranës”</b>  |  |  |
| <b>Detyra 1: Analiza e Detyres se Projektimit dhe Projekt Ideja Paraprake</b>  |  |  |
| Raporti i Studimit Paraprak; Plan i Konservimit ku përcaktohet e gjithë lista e nevojshme e ndërhyrjeve.<br><br>Projekt Ideja dhe Raportet teknike paraprakë për takimin me përfaqësues të palëve të interesit | Studimi, rilevimi, mbledhja e dokumenteve;<br>Dokumentimi grafik<br><br>Pozicionin në hartë;<br><br>Fotografi të gjëndjes ekzistuese të objektit;<br><br>Rilevimi gjeometrik dhe arkitektonik i gjëndjes ekzistuese të objektit;<br><br>Plan vendosje;<br><br>Planet në çdo nivel;<br><br>Prerje; Pamje; Elementë arkitektonike, etj.<br><ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza Historike</li> <li>• Analiza e ndërhyrjeve në periudha kohore të ndryshme</li> </ul> | 5 kopje të raportit të printuar në formatin A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm.<br><br>Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Ëord, PDF, etj. |

| DETYRA                             | PËRMBAJTJA   | FORMATI                                     |
|------------------------------------|--|---|
|                                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e strukturave</li> <li>• Analiza e materialeve</li> <li>• Analiza Statike- Strukturale</li> <li>• Diagnostifikimi i gjendjes së objektit, degradimi i materaleve, degradimi i elementëve të structures</li> <li>• studim në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore të sitit dhe vëzhgimit arkeologjik; studim mjedisor; studim topografik, studim gjeologjik, analiza strukturore, si dhe modelim dhe analiza të zgjedhura të strukturave dhe kushteve të tokës.</li> <li>• Raporti Studimit Gjeologjik</li> <li>• Raporti i Studimit Sizmik të zonës</li> <li>• Raporti i Analizës strukturore të objektit dhe analiza e materialeve.</li> <li>• Raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor</li> <li>• Lista e Ndërhyrjeve Prioritare</li> <li>• Projekt Ide Arkitektonik dhe Restaurimi të sitit së bashku me Raportin Paraprak Arkitektonik</li> <li>• Projekt idetë ndërhyrjeve strukturore, projekti konstruktiv së bashku e Raportin Paraprak Konstruktiv</li> <li>• Përgatitja e Preventivave Paraprak për çdo ndërhyrje që propozohet në listën prioritare</li> <li>• Prezantimi PP i cili do të prezantohet nga Konsulenti gjatë takimit me palët e interes.</li> </ul> |   |
| <b>Projekt Ideja Perfundimtare</b> |  |   |
| <i>Projekt<br/>perfundimtare</i>   | <i>ideja<br/>dhe</i><br>Raport teknik;   | 5 kopje të raportit të printuar në formatin |



| DETYRA  | PËRMBAJTJA  | FORMATI   |
|---|---|---|
| <p><i>raportet perfundimtare teknike.</i></p> | <p>Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, VKM 216, datë 13.04.2023 për “Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim apo në Manualin e Çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr.218, datë 18.04. 2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve(KKR)</p> <p>Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.</p> <p>Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.</p> <p>Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;</p> <p>Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;</p> <p>Rilevimi;</p> | <p>A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm.</p> <p>Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Ëord, PDF, etj.</p> |
| <p><b>Projekti i Detajuar i Zbatimit</b></p>  |   |   |

| DETYRA   | PËRMBAJTJA   | FORMATI  |
|--|--|--|
| <p>Projekti i Detajuar i Zbatimit dhe Raportet Teknik Prezantim PP, të hartuar nga persona me licensat përkatëse sipas projekteve dhe legjislacionit përkatës.</p> | <p>Projekti i Detajuar Arkitektonik dhe i Restaurimit, Raporti Arkitektonik dhe Restaurues</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza e gjendjes ekzistuese.</li> <li>- Analiza historike.</li> <li>- Rilevimi arkitektonik</li> <li>- Rilevimi gjeometrik dhe fotografik- identifikimi i tipologjisë së ndërtimit, teknikat.</li> <li>- Dokumentimi dhe rilevimi i gjendjes aktuale të elementëve artistiko-arkitektonike</li> <li>- Ndërhyrjet restauruese dhe metodologjia e ndërhyrjeve: konsolidim, përforcime, pastrime, shtesa.</li> <li>- Planimetria e çdo niveli, (dimensionimi);</li> <li>- Prerje teknike;</li> <li>- Pamje teknike (specifikimi i materialeve të rifiniturave të ndryshme);</li> <li>- Ndërhyrjet restauruese në detajet artistiko-arkitektonike.</li> <li>- Fotomontazh;</li> <li>- Animacion.</li> </ul> <p>Projekti i Detajuar Konstruktiv, Raporti Konstruktiv</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza e gjendjes ekzistuese</li> <li>- Analiza strukturale e objekteve që i nënshtrohen restaurimit;</li> </ul> <p>Në varësi të nivelit dhe llojit të ndërhyrjes përforcuese duhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planet;</li> <li>- Prerjet;</li> <li>- Detaje konstruktive (analiza shpjeguese të ndërhyrjeve);</li> <li>- Llogaritje dhe skema të vendosjes;</li> </ul> <p>Projekti i Detajuar Elektrik, Raporti Elektrik</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planet e instalimeve elektrike;</li> <li>- Ndriçimi i jashtëm;</li> <li>- Ndriçimi i emergjencës;</li> </ul> <p>Projekti i Detajuar Hidroteknik, Raporti i Instalimeve Hidroteknike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plani i kullimit, grumbullimit</li> </ul> | <p>5 kopje të raporteve të printuar në formatin A4; materiali grafik i printuar në format A3 dhe/ose A1 për planin e përgjithshëm.</p> <p>Një kopje elektronike në CD me raportin/materialin grafik/prezantimin në PPT dhe çdo document tjetër në format CAD, Excel, Ëord, PDF, etj.</p> |

| DETYRA   | PËRMBAJTJA  | FORMATI   |
|--|---|---|
|  | <p>dhe shpërndarjes së ujrave të shiut</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projekt i detajuar i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit</li> <li>- Projekti mekanik (ngrohje – ventilim)</li> </ul> <p>Preventivi i Projektit të Zbatimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Specifikime Teknike</li> <li>- Grafiku i punimeve dhe organizimi i kantjerit</li> <li>- Projektin e sistemeve të jashtme</li> </ul>                              |   |
| <b><i>Lejet e Nevojshme</i></b>  |   |   |
| <p><i>Dosja e Projektit të Detajuar të Zbatimit duhet të përfshijë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë Lejet e nevojshme në organet lokale.</i></p> | <p>Konsulenti duhet të dorëzojë Dosjet e Projektit të Detajuar të Zbatimit.</p>   | <p>Dosja e Projektit të Detajuar të Zbatimit duhet të dorëzohet në 5 kopje pranë Autoritetit Kontraktor</p>   |
| <p><i>Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social</i></p>  | <p>Konsulenti duhet të marrë miratimin paraprak të VNM-së pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 kopje të printuara dhe të firmosura, duke përfshirë licensat/certifikatat e nevojshme</li> <li>- Një kopje elektronike e raporteve në format Word dhe PDF</li> </ul> |
| <p><i>Miratimi i leje nga Institutet dhe oragnete kompetente</i></p>   | <p><b>Miratimet dhe Lejet e Detyruara:</b> Konsulenti përgatit dosjen e dokumenteve, përfshirë vlerësimin e ndikimit në trashëgiminë dhe Projektin e Detajuar të Zbatimit për lejet e detyruara për tu marrë nga organet vendore dhe të gjitha miratimet e tjera të kërkuara në proces (miratimi në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale). Miratimet e kërkuara do të identifikohen dhe kryhen nga Konsulenti, për të marrë miratimet</p> | <p>Format Elektronik</p>  |

| DETYRA           | PËRMBAJTJA   | FORMATI |
|------------------|--|---------|
|                  | <p>dhe për të kompletuar Dokumentat për Tenderim.</p> <p>Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit E-Albania, ku ofrohet mundësia e shqyrtimit të aplikimit online, në sistemin elektronik e-lejet, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.</p> |         |
| <b>Perfundim</b> |  |         |
|                  |  |         |

#### **Materiale për t’u dorëzuar:**

1. Ofertat: Konsulenti do të dorëzojë paketat e punës bazuar në planin e parashikuar të zbatimit të miratuar nga Bashkia Tiranë dhe do të përfshijë për çdo projekt investimi: (i) një dosje të detajuar të projektit (siç specifikohet në Detyrën 4); planet e vizatimeve/seksionet/fasadat/pamjet 3D/detajet/specifikimet/BoQ-të e zhvilluara në vrojtim të saktë dhe të paraqitura duke përdorur standardet dhe praktikën më të mira të projektimit; dhe (ii) dokumentet e tenderit të gatshme për procesin e tenderimit të financuara nga PIUTD dhe në koordinim me Klientin. Për detaje të mëtejshme, referojuni tabelës së rezultateve në paragrafin më poshtë.

#### **Përgjegjësi shtesë:**

1. Konsulenti duhet të përmbushë me ndërgjegje, sipas standardeve më të larta profesionale, rolin që i është caktuar të luajë. Do të jetë përgjegjësi e Konsulentit të sigurojë që të gjitha rezultatet e synuara të ofrohen gjithmonë në mënyrën më efektive dhe efektive duke siguruar efikasitet. Konsulenti do të sigurojë që të gjitha rezultatet të dorëzohen në kohë, brenda buxhetit dhe sipas standardeve më të larta.
2. Konsulenti do të zhvillojë dosjen e projekteve të detajuara të të gjitha propozimeve bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe udhëzimet, kartat kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit dhe restaurimit në mënyrë që të arrihen standardet më të larta të projektimit.
3. Konsulenti do të kryejë të gjitha diagnozat strukturore dhe analizat e strukturës (veçanërisht në trashëgiminë kulturore dhe historike të objektit/monumentit etj.), planifikimin inxhinierik dhe arkitekturor, rilevimin e objektit, analizat mjedisore, kulturore, sociale, ekonomike dhe të gjitha punët e lidhura të përshkruara deri më tani në TOR, për të mbështetur

finalizimin/përfundimin e projektit të investimit sipas objektivave dhe rezultateve të përcaktuara të projektit, duke marrë parasysh kërkesat e Bashkisë Tiranë.

4. Konsulenti do të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin në dispozicion për projektin dhe do të jetë i vetmi përgjegjës për analizën dhe interpretimin e të gjitha të dhënave të marra, për konkluzionet që ata arrijnë dhe rekomandimet që bëjnë.
5. Konsulenti do të përcaktojë qartë kufijtë e projektit dhe zonat e ndërhyrjeve për çdo projekt investimi të përzgjedhur që do të jetë nën objektin e procesit të projektimit të detajuar. Dizajni inxhinierik dhe arkitekturor duhet të marrë parasysh të marrë në konsideratë çdo zgjidhje teknike që siguron një sistem funksional brenda objektit të projektit, duke përfshirë standardet e aksesueshmërisë (p.sh. për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, si dhe fëmijët, etj.), të bazuara në mënyrën më të mirë udhëzimet e projektimit për të përfunduar projektin sipas standardeve më të larta.
6. Dizajni inxhinierik dhe arkitekturor duhet të marrë në konsideratë nevojën për zgjidhje efektive (teknike dhe estetike) dhe përdorimin e materialeve të ndërtimit që mund të zbatohen, operohen dhe mirëmbahen. Zgjedhja përfundimtare e propozuar për ndërtimin dhe restaurimin duke ruajtur të gjitha vlerat historike dhe kulturore të monumentit, do të bazohet në analizat teknike dhe financiare të projekteve alternative dhe në konsultim me Klientin.
7. Konsulentët inkurajohen, kur është e përshtatshme, të mbështesin zhvillimin më të gjerë ekonomik të vendit duke përdorur materiale dhe burime njerëzore të disponueshme në vend.
8. Konsulentët inkurajohen, kur është e përshtatshme, të mbështesin dhe prezantojnë zgjidhje dixhitale inteligjente (p.sh. teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe Interneti i gjërave (IoT)) për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve dhe për të rritur kënaqësinë e turistëve.

#### Koha e zbatimit dhe materialet për t'u dorëzuar

1. Koha e zbatimit për shërbimet e projektimit (Detyrat 1-4) sipas kësaj pike do të kryhet nga Konsulenti në 10 muaj, sipas planit të zbatimit dhe do të përbëhet nga 4 (katër) detyra. Konsulenti do të angazhojë stafin që do të mbahen për të punuar dhe komunikuar me Bashkinë Tiranë për çdo fazë të bashkëpunimit.
2. Lista e mëposhtme e rezultateve kryesore dhe pikave kryesore shërben si një udhëzues për konsulencën. Ekipi i Konsulentit pritet të propozojë një plan pune që përshkruan nën-detyrat e projektit (p.sh. sesione shtesë të shqyrtimit/konsultimit të brendshëm) dhe të përsosë afatin kohor për të përmbushur objektivat e detyrës në mënyrë efektive, për marrëveshjen e klientit:

| Nr.  | Materialet për dorëzim / Shërbimet  | Formati  | Kohëzgjatja e detyrës  | Planifikimi i pagesave                                     |
|--|---|--|--|--|
| <b>Detyra 1: Detyra 1 - Inventarizimi dhe fillimi:</b> |   |  |  |  |
| 1.1  | Raporti fillestar, plani i punës dhe strategjia e angazhimit për palët e interesuara. | <ul style="list-style-type: none"> <li>• 4 raporte të printuara në format A4.</li> <li>• Kopje elektronike e raportimeve.</li> </ul> | 1 muaj pas dhënies së kontratës. *Konsulenti duhet të kryejë të paktën 1 proces konsultimi dhe prezantimi me BT\ dhe palët përkatëse të interesit. | 10 % pas miratimit të versionit përfundimtar të produkteve |

| Nr.  | Materialet për dorëzim / Shërbimet   | Formati  | Kohëzgjatja e detyrës  | Planifikimi i pagesave  |
|--|--|--|--|---|
| <p align="center"><b><u>Detyra 2: Zhvilloni konceptin e Sistemit të Muzeut dhe përcaktoni paketën e investimeve për financim nga Bashkia Tiranë.</u></b></p> |  |  | <p align="center"><b>3.5 muaj</b> pas miratimit të Raportit Fillestar nga Klienti.</p>   | <p>40% pas miratimit të të gjitha produkteve të listuara nën Detyrë</p> |
| 2.1  | <p>Raporti i vlerësimit dhe analizës në terren (do të kryejë një hetim dhe identifikim më të saktë të aseteve materiale/jomateriale, komunikim me palët e interesuara etj.).</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 raporte të printuara në format A4 dhe/ose A3, planimetri/skica A1, A0 etc.</li> <li>- Një kopje elektronike e të gjitha raporteve/planeve të dokumenteve dhe skedarëve përkatës CAD, Excel, Word, PDF etj.</li> </ul> | <p>1 muaj pas miratimit të Raportit Fillestar.<br/>*Konsulenti duhet të kryejë të paktën 1 proces konsultimi me Klientin dhe palët përkatëse të interesuara.</p>   |   |
| 2.2  | <p>Një raport me shkrim i përbërë nga:<br/>Konceptimi</p> <p>Lista e prioritizuar e investimeve të propozuara me një plan veprimi me faza 3 alternativa të paketave investuese</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 raporte të printuara në format A4 dhe/ose A3, planimetri/skica A1, A0 etc.</li> <li>- Një kopje elektronike e të gjitha raporteve/planeve të dokumenteve dhe skedarëve përkatës CAD, Excel, Word, PDF etj.</li> </ul> | <p>2 muaj pas marrjes së miratimit për raportin e vlerësimit dhe analizës në terren. Gjatë kësaj periudhe do të kryhen hapat e mëposhtëm:<br/>*Konsulenti duhet të kryejë të paktën 2 procese konsultimi me palët përkatëse të interesit dhe Klientin mbi punën e zhvilluar.</p> <p>Një nga proceset e konsultimit do të përfshijë një prezantim dhe me Klientin e produkteve të dorëzuara. Komentet dhe sugjerimet e ofruara nga Klienti në këtë fazë do të përfshihen nga Konsulenti në dorëzimet përfundimtare, përpara se të vazhdohet në seminarin e konsultimit.</p> |   |
| 2.3  | <p><i>Ëorkshop për konsultimin me palët e interesuara</i></p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një prezantim në PoëerPoint. Materialet e prezantimit (p.sh. postera, etj.) nëse vlerësohen të nevojiten për proces.</li> </ul>   | <p>3 muaj pas fillimit të punës në Detyrën 2. * Konsulenti do të përfshijë komentet në versionet përfundimtare dhe do të ketë miratimin e Klientit për të vazhduar me Detyrën 3. * Raporti i Validimit të koncepteve të SoM dhe përzgjedhja e 1 (një) pakete investimi dhe e</p>   |   |

| Nr.  | Materialet për dorëzim / Shërbimet   | Formati   | Kohëzgjatja e detyrës   | Planifikimi i pagesave                                     |
|--|--|---|---|--|
|  |  |   | miratuar nga Klienti.   |  |
| <b><u>Detyra 3: Projektimi paraprak i konceptit, vlerësimet paraprake dhe modeli i biznesit për projekte investimi të përzgjedhura.</u></b>  |  |   | 2 muaj pas miratimit të Detyrës 2 nga Klienti.  |  |
| 3.1  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i projekteve paraprake për investime në mesin e Sarajevë. Kjo duhet të kryhet në bazë të dokumentacionit të përditësuar, vizatimeve dhe vërtetimit të sakta me kosto të parashikuara paraprake. + Modeli i biznesit.</li> <li>• Plani i zbatimit të paketave të punimeve</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 raporte të printuara në format A4 dhe/ose A3, planimetri/skica A1, A0 etc.</li> <li>- Një prezantim në Poërpint</li> <li>- Një kopje elektronike e të gjitha raporteve, planeve dhe skedarëve të lidhur me CAD.</li> </ul> | Konsulenti duhet të kryejë të paktën 1 proces konsultimi me Klientin (para prezantimit të mëposhtëm). Komentet dhe sugjerimet e dhëna do të pasqyrohen në Raportin me shkrim të Konsultimit/Komenteve. * Kjo fazë do të përfshijë një shqyrtim përfundimtar të prezantimit me Klientin dhe palët përkatëse të interesuara. * Raporti i Validimit. |  |
| <b><u>Detyra 4: Përgatitja e projektit të detajuar, lista e materialeve dhe shërbimeve të nevojshme, specifikimet teknike, raportet teknike, raportet e VNM-së, planet e menaxhimit dhe të punimeve.</u></b> |  |   | 2.5 muaj pas miratimit të Detyrës 3 nga Klienti.  | 40% pas miratimit të versionit përfundimtar të produkteve. |



| Nr.                                   | Materialet për dorëzim / Shërbimet  | Formati   | Kohëzgjatja e detyrës   | Planifikimi i pagesave   |
|---------------------------------------|---|---|---|--|
| 4.1                                   | <p>-Hartime të detajuara me specifikime teknike dhe raporte, BoQ, orar pune për investimet të përzgjedhura.</p> <p>-Koncepti i projektimit të muzeut.</p> <p>-Plan biznesi.</p> <p>-Planet e Mirëmbajtjes</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 raporte të printuara në format A4 dhe/ose A3, planimetri/skica A1, A0 etc.</li> <li>- Një kopje elektronike e të gjitha planeve të raporteve dhe skedarëve përkatës CAD, Excel, Word, PDF etj.</li> <li>- Paketa e dokumenteve dhe dokumentet përkatëse do të dorëzohen sipas kërkesave të ofertës dhe në përputhje me Udhëzimet e Bankës Botërore.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dizajni i detajuar i listës së përgjithshme të projekteve të përzgjedhura të investimit do të dorëzohet në sasinë e miratuar të paketave të punimeve nga Bashkia Tiranë në 2.5 muaj.</li> <li>- Detyra e projektimit të detajuar do të kryhet nga Konsulenti.<br/>*Konsulenti duhet të kryejë të paktën 3 procese konsultimi, ose më shumë nëse kërkohet nga Bashkia Tiranë, në varësi të numrit të paketave të punimeve.</li> </ul> | <p>30% është shuma e përgjithshme e pagesës për përfundimin e Detyrës 4. Paga do të bëhet me pranimin e versioneve përfundimtare të artikujve për çdo paketë punimesh.</p> |
| <b>Lejet dhe procesi i tenderimit</b> |   |   |   |  |
| <b>5 Miratime specifike</b>           |   |   |   |  |
|                                       | <p>Raportet e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 kopje të printuara për çdo projekt të përzgjedhur, të nënshkruara dhe të vulosura, duke përfshirë certifikatat/licencat e nevojshme, pas zhdoganimit, subjekt i ndryshimeve të kërkuara nga autoriteti lejues.</li> <li>• Një kopje elektronike e të gjitha raporteve në skedarët Word, PDF etj.</li> </ul>  | <p>*Konsulenti do të marrë miratimin e raportit nga Bashkia Tiranë duke paraqitur raportet përfundimtare që do të përdoren për marrjen e lejes/autorizimit mjedisor.</p>  | <p>10 % pas përfundimit të lejeve (përfshirë miratimet speciale) dhe lejeve të ofertimit</p>   |
|                                       | <p>Përgatitni dosjen e dokumenteve të tenderit.<br/>*Shih paragrafin 42</p>   | <p>1. 4 kopje të printuara për çdo raport konsultimi. 2. 4 kopje të printuara të Raporteve të Validimit. 3. Një kopje elektronike e raporteve (Word, PDF, etj.) 4. Gjuha shqipe/anglisht e përfshirë në një dosje.</p> <p>1. 4 kopje të printuara për çdo raport konsultimi. 2. 4 kopje të printuara të Raporteve të Validimit. 3. Një kopje</p>  |   |  |

| Nr. | Materialet për dorëzim / Shërbimet | Formati   | Kohëzgjatja e detyrës | Planifikimi i pagesave |
|-----|------------------------------------|---|-----------------------|------------------------|
|     |                                    | elektronike e raporteve (Word, PDF, etj.) 4. Gjuha shqipe/anglisht e përfshirë në një dosje.<br>1. 4 kopje të printuara për çdo raport konsultimi. 2. 4 kopje të printuara të Raporteve të Validimit. 3. Një kopje elektronike e raporteve (Word, PDF, etj.) 4. Gjuha shqipe/anglisht e përfshirë në një dosje. |                       |                        |

3. Do të ketë diskutime dhe raportime të rregullta interaktive ndërmjet ekipit të Konsulentit dhe Bashkisë Tiranë për të shkëmbyer koncepte dhe ide, për t'u siguruar që projektet e propozuara të investimit janë të realizueshme dhe praktike
4. Konsulenti do t'i paraqesë Bashkisë Tiranë për shqyrtim dhe miratim të gjitha raportet dhe produktet e kërkuara sipas kësaj detyre. Bashkia Tiranë do të jetë përgjegjëse për ndarjen e dokumentacionit me Ministrinë e Kulturës apo autoritete të tjera qendrore dhe vendore sipas nevojës.
5. Faza-B (faza e mbikëqyrjes) do të fillojë ose do të hyjë në fuqi me përfundimin me sukses të projektimit të detajuar të paketës së parë të punimeve në detyrën 4 të fazës A (faza e projektimit) dhe kur të jetë dhënë kontrata për punët civile. Kohëzgjatja e shërbimeve/kontratës në fazën e mbikëqyrjes do të varet ngushtë nga koha e lejuar për përfundimin e kontratave të punimeve siç mund të nxirret nga Faza-A. Mbikëqyrja e autorit e kërkuar gjatë ndërtimit do të shkrihet me mbikëqyrjen e ndërtimit nga konsulentët.

## 5.KONSIDERATA TE RENDESISHME

### Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me:

- Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
- Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;
- Konventat Ndërkombëtare të Restaurimit.
- Karta Shqiptare e Restaurimit dhe Karta e Venecias për konservimin dhe restaurimin e monumenteve.

Për hartimin e projektit të këtyre aseteve, konsulenti duhet të përdori standardet më të mira ndërkombëtare për këto tip objektsh (KTP89, EUROKODE etj.).

Projektet elektrike duhet të respektojnë të gjitha konditat projektuese dhe standardet që janë sot në fuqi në Shqipëri (KTP – STASH) dhe për elementë speciale që nuk parashikohen në këto standarde duhet t'i referohemi Euronorms (EN), Eurostandarteve (EN, ED) dhe rekomandimeve të CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE.

Gjatë gjithë fazave të projektimit, grupi i projektimit do të analizojë e të japë të dhëna të hollësishme për ecurinë duke u mbështetur e bashkëpunuar me Autoritetin Kontraktor.

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës,

### **Kërkesa arkitektonike e konstruktive të objektit**

Konsulentit i kërkohet të analizojë e çertifikojë të gjithë elementet arkitektonikë e konstruktivë, inxhinierike të kësaj zone ndërhyrjeje si: qëndrueshmëria, gjendja e konservimit, materialet, detajet, etj, dhe të propozojë një projekt për restaurimin dhe rikualifikimin e sitit të pasurisë kulturore.

### **Preventivi i projektit të zbatimit**

- Preventivin e zbatimit (bazuar në Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR) si dhe VKM Nr.2, datë 8.5.2003. “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit “);
- Analizën teknike të çmimeve për të gjitha zërat në preventiv bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim” si dhe manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, si dhe Manualin e çmimeve të Restaurimit, miratuar me Vendim Nr.39, datë 05.03.2015 dhe me Vendim Nr. 218, datë 18.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR)  
Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar).

### **Specifikime Teknike**

Kontraktori duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren duke patur parasysh analizat e materialeve të përdorura në konstruksionin dhe arkitekturën origjinale të gjithë elementëve të ndërtesës, duke ruajtur autenticitetin e tyre. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme :

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punimeve;
- Mënyra e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Formatet e lejuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Skica, vizatime ose foto.

**I gjithë dokumentacioni që përmbajnë CD sipas formatit PDF do të jenë të firmosura elektronikisht sipas kërkesave për pajisje me leje për ndërhyrje në Pasuri Kulturore, në bazë të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” si dhe leje ndërtimi të përcaktuara në bazë të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me VKM Nr. 271, datë 6.4.2016.**

## **Gjuha specifike e kontratës**

Gjuha në këtë kontratë pune do të jetë shqip.

## **6. Rekomandime për projektuesin**

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet objekti, sistemin ekzistues të largimit të ujërave, sistemin e furnizimit të zonës me ujë të pijshëm, distancat e lejuar si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.

### **Standarde në Projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuara, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

### **Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

### **Kërkesat për stafin**

1. Për ekzekutimin e projektit do të kërkohej një ekip shumëdisiplinor i përbërë nga personel kyç profesional dhe teknik. Ekipi i Konsulentëve duhet të udhëhiqet për tërë afatin e projektit nga një Historian i ndihmuar edhe nga një Arkitekt i cili duhet të jetë patjeter i licencuar në fushën e trashëgimisë kulturore, duke qenë se objekti është monument kulture. Udhëheqësi i Ekipit duhet të jetë me përvojë ndërkombëtare në zhvillimin e projekteve të ngjashme me qëllimin e kësaj konsulence dhe sfond në muzeografi dhe ndërhyrje në objektet e Trashëgimisë Kulturore dhe Menaxhimi i Projektit. Një arkitekt/urbanist lokal me njohuri të gjuhës lokale duhet të mobilizohet plotësisht gjatë kohëzgjatjes së konsulencës për të shërbyer si ndërlidhës. Udhëheqësi i Ekipit dhe Arkitekti/Planifikuesi Urban duhet të bëjnë një minimum vizitash në terren në zonat e projektit secila si pjesë e zhvillimit të shërbimeve të projektimit, të cilat do të pasqyrohen në planin e punës dhe do të jenë objekt i procesit të vlerësimit. Në të vërtetë, prania e tyre konsiderohet e detyrueshme. Kjo nuk kufizon praninë e anëtarëve të tjerë të ekipit nëse vlerësohet e rëndësishme nga Konsulenti, në konsultim me Bashkinë Tiranë.

2. Listat e mëposhtme të kualifikimeve shërbejnë si udhëzues dhe Ekipi i Konsulentëve me arsyetim mund të propozojë staf shtesë. Ekipi i Konsulentit do të propozojë gjithashtu caktimin e kohës për secilin prej stafit të dedikuar për detyrat e tyre përkatëse dhe ndarjen e kohës që ato punë do të kryhen në vendndodhje ose në distancë. Përbërja e ekipit të propozuar për kontratë do të jetë:
3. Përveç sa më sipër, për zhvillimin e detyrës është e detyrueshme prania e një eksperti lokal të trashëgimisë kulturore me licencë përkatëse të lëshuar nga Ministria e Kulturës. Të tjerë ekspertë kyç parashikohet të angazhohen nga Konsulenti nëse ndonjë shërbim i specializuar vlerësohet dhe nevojitet gjatë zbatimit të detyrës, me propozimin e Konsulentit dhe miratuar nga Bashkia Tiranë ose me kërkesë të BT nëse konsiderohet e nevojshme. Sigurimi i kohës do të vlerësohet në bazë të detyrës që do të kryejë eksperti i mobilizuar.
4. Nuk do të lejohen ndryshime në përbërjen e ekipit dhe anëtarëve të ekipit gjatë zbatimit të detyrës, përveç rasteve kur autorizohen bashkërisht nga BT dhe Konsulenti.
5. Detyra e shërbimeve të projektimit duhet të kryhet brenda një periudhe 1-vjeçare.

Konsulenti do të sigurojë një ekip me përvojë në projektim, që mbulon disiplinat e nevojshme për kryerjen e duhur të shërbimeve. Ekipi i projektimit duhet të ketë eksperiencë në: restaurim, projektimin e ndërtesave civile, në infrastrukturë; në mënyrë që të mbulojë çdo disiplinë të nevojshme për përgatitjen e këtij projekti.

Për shkak të natyrës së veçantë të shërbimeve, përfshirja e ekspertëve në mënyrë të përshtatshme të kualifikuar do të jetë një kërkesë thelbësore për marrjen e projektit optimal me kosto efektive si dhe sigurinë për investime të qëndrueshme.

Pjesë e grupit të projektimit restaurues duhet të jenë:

- Projektues Konstruktor;
- Projektues Restaurator; Sipas VKM Nr. 792 dt. 07.10.2020, i ndryshuar me VKM Nr. 329, dt. 02.06.2021
- Projektues Arkitekt;
- Projektues Instalator mekanik dhe elektrik;
- Projektues Vepra Hidraulike;
- Projektues Gjeodet;
- Studime Projektues Gjeologo – Inxhinierik – Hidrogeologjik;
- Studime të Sizmologjisë Inxhinierike;
- Ekspert mjedisi;
- Ekspert për Mbrojtjen nga Zjarri;

### **1. Drejtues**

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master (3+2) ose ekuivalente universitare në Etnografi.

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me krijimin, restaurimin, rehabilitimin apo rikonceptimin e muzeve në vend ose jashtë.
- B. Përvojë në projekte të dizajnit të brendshëm dhe ndërhyrje në ndërtime që janë objekte të trashëgimisë kulturore.
- C. Të jetë njohës i mirë dhe të ketë kontribute botime/punë kërkimore/konferenca/artikuj për tematika që lidhen me historinë e Tiranës, sidomos pas vitit 1614.
- D. Të hartojë një metodologji të përshtatshme studimi dhe bashkëpunimi me specialistë në fusha të ndryshme specifike.
- E. Të ketë aftësi drejtuese, menaxhuese dhe përgjegjshmëri në ambientin profesional.

## 2. Studiues i arkitekturës tradicionale

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master (3+2) ose ekuivalente universitare në Arkitekturë.

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me krijimin, restaurimin, rehabilitimin apo rikonceptimin e muzeve në vend ose jashtë.
- B. Përvojë në projekte të dizajnit të brendshëm dhe ndërhyrje në ndërtime që janë objekte të trashëgimisë dhe të jetë i pajisur me liçence restaurimi të lëshuar nga Ministria e Kulturës, që të përmbajë në pikat e licensimit kategorinë përkatëse të projektimit.

## 3. Historian

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master (3+2) ose ekuivalente universitare në Arkitekturë.

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me krijimin, restaurimin, rehabilitimin apo rikonceptimin e muzeve në vend ose jashtë.
- B. Përvojë në projekte të dizajnit të brendshëm dhe ndërhyrje në ndërtime që janë objekte të trashëgimisë kulturore.
- C. Të jetë njohës i mirë dhe të ketë kontribute botime/punë kërkimore/konferenca/artikuj për tematika që lidhen me historinë e Tiranës, sidomos pas vitit 1614.

## 4. Muzeolog

Diplomë në fusha si Muzeologji/Histori/Arkivistikë/Trashëgimi Kulturore/Etnografi.

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që lidhen me muzealizimin.
- B. Të ketë kryer më parë detyra që lidhen **me inventarizimin dhe krijimin e databazave për objekte muzeale** që bartin vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.
- C. -Ai/Ajo duhet të ketë punuar në projekte të ngjashme (p.sh. projekte muzeale, ekspozita, dizajn të brendshëm, etj.). Projekte të hartuara të vendosura në zona të trashëgimisë kulturore si: rehabilitimi i aseteve kulturore, restaurim, adaptim, etj.

## 5. Etnograf

Diplomë në fusha si Muzeologji/Histori/Arkivistikë/Trashëgimi Kulturore/Etnografi

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që kanë patur në fokus të tyre muzealizimin.
- B. Të ketë kryer më parë detyra që lidhen **me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e informacionit** që do t'i paraqitet vizitorëve **për objekte muzeale** që bartin vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.
- C. Ai/Ajo duhet të ketë punuar në projekte të ngjashme (p.sh. projekte muzeale, ekspozita, etj).
- D. Projekte të hartuara të vendosura në zona të trashëgimisë kulturore si rehabilitimi i aseteve kulturore, restaurimi, adaptimi, ripërdorimi, etj.

## 6. Etnograf

- A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte që kanë patur në fokus të tyre muzealizimin.
- B. Të ketë kryer më parë detyra që lidhen **me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e informacionit që do t'i paraqitet vizitorëve përmes mjeteve digjitale të komunikimit** qofshin ato të instaluara në muze apo pjesë e aplikacioneve që mund të zhvillojë institucioni.
- C. Ai/Ajo duhet të ketë punuar në projekte të ngjashme (p.sh. projekte muzeale, ekspozita, etj).
- D. Projekte të hartuara të vendosura në zona të trashëgimisë kulturore si rehabilitimi i aseteve kulturore, restaurimi, adaptimi, ripërdorimi, etj.

### **7. Studiues i etnokulturës (kulinari)**

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare përkatëse për fushën e propozuar.

### **8. Studiues i etnokulturës (muzikolog)**

Ekspertët duhet të kenë diplomë universitare përkatëse për fushën e propozuar.

### **9. Arkeolog**

Ai/ajo duhet të ketë së paku një diplomë master (3+2) ose ekuivalente universitare në Arkeologji

A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare në projekte të ngjashme.

B. Të jetë njohës i mirë dhe të ketë kontribute botime/punë kërkimore/konferenca/artikuj për tematika që lidhen me rezultatet e arritura në arkeologji për zonën e Tiranës së bashku me njësitë administrative që e përbëjnë atë.

### **10. Kurator i ekspozitave (dhomave)**

MA në Arte Pamore dhe Studime Kuratoriale ose diplomime dhe kualifikime të ngjashme në Arte Pamore dhe Performuese, Menaxhim Artesh.

A. Të ketë eksperiencë pasuniversitare si kurator i muzeve, ekspozitave dhe të ngjashme me qëllimin e kësaj konsulence.

B. Të ketë përvojë në riinterpretimin e muzeut në temat përkatëse që kanë të bëjnë me historinë, trashëgiminë kulturore, traditën, etj.

### **11. Projektues i multimedias**

Diplomë Master në Marketing, Multimedia, Web, Dizajn Grafik, Komunmikum Vizual ose përvojë ekuivalente.

A. Të sigurojë një kuadër të qartë konceptual se çfarë është një ekspozitë, si impakton ajo vizitorët, si është organizuar dhe çfarë mund të presin të mësojnë prej saj.

B. Të ketë eksperiencë pasuniversitare si kurator i muzeve, ekspozitave dhe të ngjashme me qëllimin e kësaj konsulence.

C. Njohuri dhe përvojë të thellë në disiplinat multimediale.

D. Të ofrojë shërbime të specializuara të dizajnit grafik.

E. Të prodhojë video të specializuara dhe shërbimet e dizajnit audio për zhvillimin e ekspozitave muzeale të përhershme dhe programet video të muzeut.

F. Të jetë përgjegjës për riparimin, mirëmbajtjen dhe instalimin e ekraneve, kutive, standave, pajisjeve dhe aksesoreve për ekspozitat e përhershme.

G. Të ketë përvojë në riinterpretimin e muzeut në temat përkatëse që kanë të bëjnë me historinë, trashëgiminë kulturore, traditën, etj.

### **12. Përkthyes**

Diplomë në përkthim të gjuhës angleze.

### **13. Redaktor**

Diplomë në gjuhë ose letërsi shqipe.

### **14. Ekspert i komunikimit**

Diplomë në shkenca komunikimi.

**PËRGJEGJËSITË E KONSULENTIT**

Konsulenti do të jetë përgjegjës për zbatimin në tërësi të detyrave të përcaktuara në dokumentin në fjalë. Për këtë qëllim, Konsulenti do të mbartë të gjitha shpenzimet që lidhen me punësimin dhe mobilizimin e ekipit të tij të ekspertëve. Kjo përfshin shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit.

Asnjë objekt nuk do të sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për kostot e prodhimit, përkthimit, shtypjes dhe shpërndarjes së të gjithë materialeve informative, dokumenteve dhe raporteve të kërkuara për kryerjen e detyrës.

Konsulenti do të jetë i vetmi përgjegjës për përmbushjen në kohë dhe në mënyrë cilësore të të gjitha çështjeve të përmendura më lartë në këtë detyrë.

Gjithashtu duhet te kihet ne konsiderate se:

Sipas Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”:

36. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në:

a) “Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili **ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.**

- **Raportimi**

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dëg” (autoCad). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

- **Investimi Themelor**

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mire i aprovuar.